



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 20 Janar 2017

Njoftim

Rritja e sasisë dhe konsumit të barnave që qarkullojnë në treg Raporti vjetor i barnave për vitin 2016

Sigurimi i vazhdueshëm i barnave me kualitet të lartë për nevojat e të siguruarve është angazhimi i vazhdueshëm i punës së Fondit për sigurim shëndetësor. Me Listën pozitive të barnave mbulohet një sasi e madhe e barnave të shpërndara nëpër baratorët që kanë marrëveshje me Fondin, duke ju ofruar të siguruarve mundësinë për përzgjedhje më të gjërë të barnave. Sasia dhe shumëllojshmëria e barnave që mund të merren me recetë ka arritur deri 1.210 barna me emër të mbrojtur nga prodhues të ndryshëm. Në fakt këto barna përfshijnë 427 gjenerikë me fortësi dhe formë dozimi prej të cilave 75% janë barna pa kosto shtesë, përveç participimit i cili zbatohet në pajtueshmëri me rregullat ligjore.

Këto barna të siguruarit i marrin me recetë nga mjeku amë ndërsa për një lloj të veçantë të barnave është i nevojshëm rekomandimi i mjekut specialist/subspecialist. Me barnat e Listës pozitive, të siguruarit mund të furnizohen nga 776 barnatore të shpërndara nëpër territorin e Republikës së Maqedonisë prej të cilave, 695 janë barnatore nëpër mjediset urbane, 72 janë stacione farmaceutike, 6 janë barnatore mobile dhe 3 janë barnatore rurale. Për këtë arsye, buxheti për barnat me recetë në vitin 2016 u rrit në vlerë prej 2,55 miliard denarëve për dallim nga buxheti i vitit 2015 i cili ishte 2,46 miliard denarë, ndërsa tani, në vitin 2017 buxheti për barna është rritur edhe për 200 milion denarë shtesë.

Rritja e numrit të barnatoreve që kanë marrëveshje me Fondin, rritja e buxhetit për barna, efektet pozitive të masave të ndërmarra nga Fondi dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë të cilat u implementuan viteve të fundit me qëllim që të sigurohet sasi e mjaftueshme e barnave për nevojat e të siguruarve, vërtetohen me të dhënat e raportit vjetor të vitit 2016, të dhëna që dëshmojnë rritjen e konsumit të barnave me recetë në kuadër të Fondit.

Nëse krahasojme vitin 2009 atëherë kur edhe filloi të zbatohet sistemi për çmimet referente të barnave prej të cilave vetëm 20% e tyre kanë qenë pa kosto shtesë, dukshëm vërehet efekti pozitiv respektivisht rritja katërfish e sasisë së barnave me recetë ose rreth 75% nga numri i përgjithshëm i barnave që janë pa kosto shtesë në vitin 2016. Kjo tregon se Fondi ka arritur t'i kursejë mjetet personale të personave të siguruar.

Në zgjerimin e paletës së Listës parësore të barnave ndikojnë shumë faktorë edhe atë: rritja dhe shpërndarja efikase e mjeteve financiare ose ndryshe kuota e barnatoreve; mundësia e dhënies së barnave të shtrenjta jashta kornizës së kuotave; zbatimi i metodologjisë krahasuese që përcakton çmimet referente



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



të barnave të listës pozitive me anë të së cilës shumë barna pësuan ulje të çmimeve; shprehitë e mjekëve për përshkrimin e barnave si dhe struktura dhe nevoja e popullatës.

Të dhënat sa i përkasin konsumit të barnave me recetë që i mbulon Fondi, ndërvite shënojnë rritje të vazhdueshme. Sa për krahasim, në vitin 2002 për 8 milion receta janë ndarë 1,2 miliard denarë, në vitin 2008 për 10 milion receta janë ndarë 1,3 miliard denarë, ndërsa prej 01.09.2016 Fondi ka dyfishuar buxhetin për barnat me recetë respektivisht ka ndarë mjete prej me 2,55 miliard denarëve.

Dallimi i situates së tanishme me atë para 10 viteve është i dukshëm dhe kjo lehtë vërehet tek barnatoret respektivisht, është evituar turma e rradhëve të gjata, nuk ka deficit të barnave dhe të siguruarit nuk i paguajnë privatisht barnat me çmime shumë të larta.

Tabela nr.1 – Përshkrimi i numrit të recetave të realizuara dhe vlera financiare e tyre (të shprehura në denarë) për periudhën kohore 2008 - 2016

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i recetave të realizuar në barnatore	10.288.509	14.965.727	15.277.792	16.332.551	17.485.146	17.822.132	19.385.458	21.129.626	22.274.288
Dallimi nga viti i kaluar (%)		45%	2%	7%	7%	2%	9%	9%	5%
Vlera totale e faturuar nga barnatoret (miliard denarë)	1,319	1,829	1,778	1,902	1,993	2,124	2,263	2,425	2,626
Dallimi nga viti i kaluar (%)		39%	-3%	7%	5%	7%	7%	7%	8%

Trendi rritës i konsumit të barnave vazhdon edhe në vitin 2016. Numri i recetae të realizuara në këtë periudhë është 22 milion e 274 mijë ose rritje prej 5,4% nga viti 2015. Vlera e faturuar e barnave në vitin 2016 është 2 miliard e 626 milion denarë ose rritje rreth 8,2% nga viti 2015.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Në vitin 2016 - 1,23 milion të siguruar janë furnizuar me barna me recetë ose 66,4% nga numri i përgjithshëm i të siguruarve në nivel shtetësor.

- Nga gjithsej 14 grupet e barnave do t'a veçojmë konsumin e barnave që janë pjesë e grupeve të sistemit ATC¹ e sidomos grupa C – marrin pjesë barnat e sistemin kardiovaskular me 9.667 milion receta të realizuara. Konsumi i këtyre barnave në vitin 2016 është i rritur për 4,8% nga viti 2015, mjetet financiare janë rritur për 6,7% nga viti 2015. Vlera e mjeteve të shfrytëuara për këtë grup të barnave në vitin 2016 ka qenë 717,98 milion denarë dhe janë furnizuar gjithsej 464.887 persona të siguruar.
- Barnat që janë pjesë e grupeve të sistemit ATC, grupa R – marrin pjesë barnat që kanë efekt në sistemin e frymëmarrjes, janë të dytët me radhë sa i përket konsumit respektivisht me 1,08 milion receta të realizuara. Konsumi i këtyre barnave në vitin 2016 është i rritur për 4,9% nga viti 2015, mjetet financiare janë rritur për 11,7% nga viti 2015. Vlera e mjeteve të shfrytëzuara për këtë grup të barnave në vitin 2016 ka qenë 400,96 milion denarë dhe janë furnizuar gjithsej 278.068 persona të siguruar.
- Barnat që janë pjesë e grupeve të sistemit ATC, grupa N – marrin pjesë barnat që kanë efekt në sistemin nervor, janë të tretët me radhë sa i përket konsumit respektivisht me 3,37 milion receta të realizuara. Konsumi i këtyre barnave në vitin 2016 është i rritur për 3,72% nga viti 2015, mjetet financiare janë rritur për 8,9% nga viti 2015. Vlera e mjeteve të shfrytëzuara për këtë grup të barnave në vitin 2016 ka qenë 397,6 milion denarë dhe janë furnizuar gjithsej 413.548 persona të siguruar.

Nga të dhënat e analizave të bëra vijmë në përfundim se konsumi i barnave nëpër të gjitha rajonet shënon rritje. Rajoni i Shkupit njihet si rajoni me konsumueshmëri më të madhe, ndërsa rajoni Verilindor me konsumueshmëri më të ulët.

Rajoni i Shkupit është rajoni në të cilin më së shumti konsumohen barnat me recetë nga ana e të siguruarve edhe atë me 6 milion e 920 mijë receta (rreth 31,06%). Konsumi i barnave sipas vlerës më të lartë financiare përsëri vërehet në Njësinë rajonale të Shkupit me gjithsej 861 milion e 107 mijë denarëve (rreth 32,8%), më pas rradhitet rajoni i Pollagonisë me 2.944 milion receta me vlerë prej 331,5 milion denarëve dhe vendin e tretë e zë rajoni i Pollogut me 2.475 milion receta me vlerë prej 279,9 milion denarëve.

Në top listën e 10 barnave më të konsumuara për nga vlera financiare, Fondi në vitin 2016 ka ndarë 904,2 milion denarë ose 34,4% nga vlera totale e barnave ndërsa, në top listen e 10 barnave më të konsumuara

¹ Anatomik, Terapeutik, Kimik



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk


Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



për nga numri i recetave janë realizuar 9,32 milion receta ose afërsisht 42% nga numri i përgjithshëm i recetave.

Top lista e tre barnave më të konsumuar sipas vlerës, janë këto gjenerikë:

- Atorvastatin – bar për uljen e sasisë së yndyrës në gjak, të cilin me recetë e kanë konsumuar 109.309 të siguruar ose 5,9% nga mesatarja e numrit të përgjithshëm të personave të siguruar
- Tamsulosin – bar për relaksim e muskulaturës së prostatës, e kanë konsumuar 42.558 ose 2,3% nga mesatarja e numrit të përgjithshëm të personave të siguruar
- Salmeterol + fluticasone – bar për sistemin e frymëmarrjes, kundër astmës dhe sëmundjes pulmonare obstruktive kronike, e kanë konsumuar 9.513 ose 0,5% nga mesatarja e numrit të përgjithshëm të personave të siguruar



Top lista e tre barnave më të konsumuar sipas numrit të recetave të realizuara, janë këto gjenerikë:

- Enalapril – bar për uljen e tensionit të lartë të gjakut, e kanë konsumuar 176.321 ose 9,5% nga mesatarja e numrit të përgjithshëm të personave të siguruar




FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



- Metformin – bar për regullimin e sasisë së sheqerit në gjak, e kanë konsumuar 91.471 ose 4,9% nga mesatarja e numrit të përgjithshëm të personave të siguruar
- Diazepam – bar për frenimin e sistemit nervor (qetësues), e kanë konsumuar 216.024 ose 11,7% nga mesatarja e numrit të përgjithshëm të personave të siguruar



Të siguruarit për Fondin janë paraqesin dhe politikat tona i krijojmë me qëllim që të kënaqim të siguruarit dhe të ofrojmë shërbime shëndetësore me kualitet më të lartë.